



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

RR E G U L L O R E **PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË** **PODUJEVËS**

Podujevë, 31 janar 2023

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c), 17 shkronja f) dhe 40.2 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 32 paragrafi 5, ndërlidhur me nenin 7 paragrafit 8, nenin 12 paragrafit 2, nenin 15 paragrafit 2, nenin 17 paragrafit 5 dhe nenin 35 paragrafit 2 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, neneve 14, 15 paragrafi 2.3, nenit 19 paragrafi 1.6 dhe nenit 34 paragrafi 2.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 datë 29 qershor 2018, në propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2023, miratoi këtë;

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave brenda kufijve administrativ të komunës, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në treg, si dhe ofrimin e shërbimeve në tregun e sektorit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Me këtë Rregullore përcaktohen kompetencat e Komunës në rregullimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, procedura për licencimin e operatorëve në ofrimin e transportit rrugor, certifikimi, llojet transportit, obligimet dhe të drejtat e operatorëve të transportit, mbikëqyrja dhe inspektimi rrugor, gjobat për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, si dhe çështje të tjera të cilat lidhen me transportin.
3. Kjo Rregullore rregullon kushtet e qasjes në treg te operatoreve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave që përdor të paktën një mjet motorik ose një tërësi mjetesh pesha e mjetit e të cilëve është mbi tre pikë pesë (3.5) tonë dhe jo më pak se gjashtë (6) tonë pesha e përgjithshme për të kryer transportin e mallrave, ose të paktën me një automjet i cili është teknikisht në gjendje të rregullt, për nga lloji i konstruktimit dhe pajisjeve, me kapacitet me më shumë se tetë plus një (8+1) ulëse, përfshirë edhe ngasësin për të kryer transport të udhëtarëve.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik të cilët ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në territorin e Komunës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdora në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ministria** – Ministria përkatëse për transport;
- 1.2. **Komunë** – Komuna e Podujevës si njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale;
- 1.3. **Drejtori** – Drejtoria e shërbimeve publike, mbrojtje dhe shpëtim në Komunë;
- 1.4. **Operator-taksi** – Veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;
- 1.5 **Stacion i autobusëve** – Objekti me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve dhe udhëtarët;
- 1.6. **Itinerar** – Akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;
- 1.7. **Certifikatë e automjetit** – Dokument të cilin e lëshon organi kompetent për çdo automjet veç e veç dhe i cili përmban të dhënat për: lëshuesin e organit kompetent, operatorin e transportit, numrin e licencës, përkatësisht lejes, shenjën (targat) e regjistrimit, markën tipin, numrin e shasisë së automjetit, kapacitetin bartës, llojin e transportit që mund të kryhet, datën e lëshimit të certifikatës, vulën dhe nënshkrimin;
- 1.8. **Operator i transportit rrugor të mallrave** – Veprimtarinë e çdo operatori transportues të mallrave që kryen transport për nevoja personale dhe palë të tretë, me anë të mjeteve motorike ose të mjeteve të kombinuara;
- 1.9. **Operator i transportit rrugor të udhëtarëve** – Veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori transportit;
- 1.10. **Menaxher transporti** – Një person fizik i cili posedon certifikatën e kompetencës profesionale për menaxher (CPC) sipas dispozitave të Ligjit të Transportit i punësuar nga një apo më shumë por jo me tepër së katër (4) operator të transportit rrugor me anë të një kontrate, të cilët në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme menaxhon aktivitetet e transportit të atij operatori;
- 1.11 **Licencë** – Akti me të cilin operatori i transportit rrugor lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave;
- 1.12. **Linjë** – Relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;
- 1.13 **Linjë urbane** – Linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune - qyteti;
- 1.14. **Linjë urbane-periferike** – Linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit Komunës;
- 1.15. **Udhëtar** – Personi / personat fizik të cilët transportohen nga operatorët e transportit rrugor me kompensim dhe i cili në bazë të kontratës ka të drejtë transporti;
- 1.16. **Transport i veçantë** – Transportin e vetëm një numri të caktuar të udhëtarëve i cili kryhet në bazë të kontratës me shkrim ndërmjet operatorit të transportit dhe porositësit të transportit, me ç'rast transportin e paguan porositësi;

- 1.17. **Transport për nevoja vetanake** – Transport i personave ose të mallrave të cilin e kryejnë pa kompensim personat fizikë ose juridikë, për t'i plotësuar nevojat e prodhimit ose të shërbimeve në kuadër të veprimtarive të veta;
- 1.18. **Relacion** – Distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;
- 1.19. **Drejtues** – Person që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e automjetit transportues;
- 1.20. **Rendi i udhëtimit** – Akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vend ndaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vend ndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën brenda të cilës mbahet linja dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit;
- 1.21. **Tahografi** – Aparati i destinuar që të jetë i instaluar brenda automjetit për të treguar dhe regjistruar në mënyrë automatike apo gjysmë automatike të dhënat mbi rrugëtimin e këtyre automjeteve dhe mbi disa, kohën e punës të ngasësve të tyre;

Neni 4

Kompetencat e Komunës për rregullimin e transportit

- 1. Kuvendi i Komunës me propozim të Drejtorisë është përgjegjëse për:
 - 1.1. Përcaktimin e politikave të zhvillimit të shërbimeve të transportit rrugor të sigurt, efikase dhe ekonomike brenda kufijve administrativ të Komunës;
 - 1.2. Hartimin dhe miratimin e planit të transportit rrugor lokal, cili nuk duhet të jetë në kundërshtim me rregullat e linjave ndër-urbane të aprovuar dhe miratuar nga Ministria;
 - 1.3. Ndryshimin e planit të transportit lokal jo me vonë se pesë (5) vite nga data e nxjerrjes së tij, i cili duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit rrugor në Kosovë;
 - 1.4. Publikimin e Planit të transportit lokal apo planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ja dërgon Ministrisë;

Neni 5

Rregullat e përgjithshme të përcaktuara nga Komuna

- 1. Komuna me akt administrativ cakton rregullat lidhur me veprimtarinë e operatorëve të transportit të udhëtareve dhe mallrave në Komunë, duke përfshirë:
 - 1.1. Rregullimin ose ndalimin e përdorimit të autobusëve publik në rrugë apo rajone të caktuara;
 - 1.2. Marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve;
 - 1.3. Krijimin dhe mbajtjen e regjistrave dhe inspektimin e tyre;
 - 1.4. Transportin e bagazhit të udhëtarëve ose mallrave tjera;
 - 1.5. Rregullimin ose ndalimin e transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë, lejohet nëse mjeti i transportit publik ka mbajtëse sipas standardeve;
 - 1.6. Shpejtësinë maksimale të automjeteve me kapacitet me më shumë se tetë plus një (8+1) ulëse, që përfshirë ngasësin për të kryer transport të udhëtarëve - 50 km/h;
 - 1.7. Dizajnin, pajisjet, mjetet e brendshme ose të jashtme të autobusëve publik, i lejohet me lejen e organit gjegjës;
 - 1.8. Pikat e stacioneve dhe vend ndaljen për linjat e autobusëve, dhe
 - 1.9. Rregullimin ose ndalimin e shpalljeve, shenjave dhe reklamave brenda apo jashtë autobusëve

publik;

2. Linjat e përhershme të transportit publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve vendosen nga Komuna në përputhje me Planin e transportit lokal

- 1.1. Relacionet për shkuarje dhe ardhje të udhëtarëve, të mbulohet vetëm me një mjetë të transportit (autobus apo minibus), për veç nëse ka: prishje të mjetit transportues, vonesa për arsyeje të aksidenteve në rrugë apo dendësisë së automjeteve, e të ngjashme, mund të shfrytëzohet edhe një mjetë tjetër transportues (rezervë) për mbulim të orarit të udhëtimit.
- 1.2. Intervali kohor mbrojtës ndërmjet nisjeve, të jetë aq sa nuk paraqet konflikt brenda operatorëve të linjave.

Neni 6

Ushtrimi i veprimtarisë së operatorëve

1. Veprimtaria e operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave bëhet në bazë të licencës e cila lëshohet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
2. Operatorët e transportit rrugor të cilët kryejnë veprimtarinë e transportit rrugor në Komunës e Podujevës, janë të detyruar:
 - 2.1. Të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt sipas kriterëve të përcaktuar me ligj;
 - 2.2. Të mbajnë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet lidhur me veprimtarinë e vetë transportuese;
 - 2.3. Të plotësojnë evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me Ligj;
 - 2.4. Të mbajnë dokumentet në automjetet transportuese përkatëse sipas Ligjit për Transportin Rrugor.
3. Operatori i transportit i cili bënë transportin e rregullt publik në pajtim me kushtet dhe kapacitetet disponuese të automjeteve duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtari apo malli të cilët sipas rregullave të veçanta nuk janë të përjashtuar nga transporti.

Neni 7

Licenca e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave

1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave nuk mund të ushtrojë veprimtarinë para se të pajiset me licencë, certifikatë dhe rend të udhëtimit.
2. Licenca është e domosdoshme për:
 - 2.1. Transportin e rregullt të udhëtarëve;
 - 2.2. Transportin taksi të udhëtarëve
 - 2.3. Transportin e mallrave, dhe
 - 2.4. Terminalet e mallrave (stacionet e ngarkesave).
3. Licenca, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk është e nevojshme për automjetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Forcat e armatosura ndërkombëtare, Policinë e Kosovës, ndihmës së shpejtë, zjarrfikësve, institucionet publike dhe njësitë e shpëtimit, dhe për automjetet me peshë deri tre pikë pesë (3.5) tonelata apo peshë e përgjithshme nuk tejkalon gjashtë (6) tonelata.

Neni 8

Kushtet dhe kriteret për licencimin e operatorëve të transportit rrugor dhe të mallrave

1. Për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, operatori duhet të plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të jetë i regjistruar në Kosovë;
 - 1.2. Selia e kompanisë të jetë në territorin e Komunës së Podujevës;
 - 1.3. Të ketë reputacion të mirë;
 - 1.4. Të posedojë dëshminë e lëshuar nga gjykata kompetente se menaxheri i operatorit nuk ka pengesa ligjore të zhvillojë veprimtarinë në lëmin e transportit;
 - 1.5. Të posedojë dëshminë e lëshuar nga ATK që operatori nuk ka pengesa të natyrës administrative fiskale;
 - 1.6. Të ketë kapacitete të përshtatshme dhe të qëndrueshme financiare, të cilën e vërteton në bazë të pronësisë mbi mjetet apo garancionit financiar/bankar;
 - 1.7. Të ketë menaxher transporti me kompetencën e nevojshme profesionale
 - 1.8. Të ketë në pronësi së paku dy (2) autobusë apo minibusë;
 - 1.9. Të ketë automjetet e transportit në gjendje të mire teknike-eksplotuese.
2. Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku pesë (5) vitesh.
3. Licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve, mallrave stacioneve të autobusëve dhe terminaleve të mallrave, jepen kundrejt pagesës që parasheh Rregullorja e Komunës për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale.

Neni 9

Revokimi i licencës

1. Operatori të drejtën e licencës për veprimtarinë e transportit rrugor dhe të mallrave mund ta humbë kur:
 - 1.1. Operatori falimenton dhe vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente;
 - 1.2. Mbaron afati i vlefshmërisë së licencës, dhe
 - 1.3. Kërkohet nga mbajtësi i saj që të ndërpres të drejtën në licencë;
2. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit revokohet nga organi që e lëshon atë kur:
 - 2.1. Vërtetohet se operatori ka humbur njërën nga kushtet e përcaktuar për qasjen në treg të operatorëve të transportit rrugor dhe të mallrave të përcaktuara në nenin 8 të këtij akti;
 - 2.2. Mbajtësi i licencës apo lejes shkel detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe aktet tjera ligjore.
3. Licenca për veprimtarinë e transportit i hiqet në mënyrë të përhershme nga organi komitent, operatorit që është dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e veprës penale për kontrabandë me narkotik dhe trafikim më qenie njerëzore.
4. Propozimin për inicimin e procedurës për revokimin e licencës sipas paragrafit 2 dhe 3. të këtij neni e bënë Inspektorati i Komunës.
5. Vendimi merret nga organi që e ka lëshuar atë, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga inspektorët e transportit rrugor pran Komunës.

Neni 10

Certifikata e automjetit

1. Drejtoria ka kompetencë të certifikojë automjetet e transportit me më shumë se tetë plus një (8 + 1) ulëse për transportin urban dhe urbano-periferik.
2. Certifikata e automjetit është pjesë përbërëse e licencës të cilën e lëshon organi kompetent për çdo automjet në emër të operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave të cilët janë të licencuar nga Komuna.
3. Certifikata e automjetit lëshohet në emër të operatorit transportues e cila është e pa tjetërsueshme dhe e pa transferueshme dhe është pjesë e licencës.
4. Operatori i transportit rrugor është i detyruar që me rastin e shitjes së automjetit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të kthejë atë tek autoriteti i cili e lëshon atë.
5. Me rastin e aplikimit për t'u pajisur me certifikatë të mjetit transportuese me më shumë se 8 plus një (8+1) ulëse, operatori duhet të bashkëngjisë këto dokumente:
 - 5.1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit (librezës) të automjetit transportues;
 - 5.2. Dëshmitë se vjetërsia e mjetit transportues është sipas euro-kodeve të përcaktuara me planin e mobilitetit të transportit në Komunë;
 - 5.3. Kopja e polisës së sigurimit;
 - 5.3. Kopja e vërtetimit për aparatit zjarrfikës;
 - 5.4. Kopja e vërtetimit të tahografit;
 - 5.5. Certifikata se mjeti është teknikisht i rregullt;
 - 5.6. Në mjeti të jetë i shkruar në të dy anët mbishkrimi i emrit të firmës (shkronja me madhësi mbi 20 cm);
6. Certifikata e automjetit të transportit është e përhershme përveç në rast të ndërrimit të pronarit të licencës së operatorit të transportit rrugor dhe të mallrave.

Neni 11

Regjistri elektronik i operatorëve

1. Të gjithë operatorët e transportit rrugor që kanë licencë, regjistrohen në regjistrin elektronik të operatorëve të transportit rrugor që mbahet nga organi kompetent i ngarkuar për transport në Komunë.
2. Regjistri përmban të gjitha të dhënat lidhur me licencat, lejet, certifikatat e automjeteve transportuese dhe menaxherët e transportit të të gjithë operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në komunë.
3. Në regjistër ka qasje publiku duke respektuar zbatimin e dispozitave lidhur me të dhënat me karakter personal.

KREU II

TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 12

Transporti rrugor i udhëtarëve

1. Komuna është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e këtyre llojeve të transportit brenda territorit të vet:

- 1.1. Transportin e rregullt të udhëtarëve;
- 1.2. Transportin i veçantë i udhëtarëve;
- 1.3. Transportin taksi të udhëtarëve, dhe
- 1.4. Transportin e udhëtarëve për nevoja vetanake.

Neni 13

Transporti i rregullt i udhëtarëve brenda Komunës

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobus, kryhet në relacionet e caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit të përcaktuar dhe vërtetuar më parë nga Komuna, çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve tjera të transportit.
2. Kuvendi me propozim të Drejtorisë miraton rrjetin e linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e operimit.
3. Transporti publik urban i udhëtarëve në trafikun linjorë kryhet me linja të përhershme, me të cilat transporti kryhet për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit apo në periudhë të caktuar të vitit.
4. Transporti urban dhe urban-periferik mund të kryhet si transport i rregullt dhe i njëjti mund të subvencionohet nga Komuna.
5. Komuna mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve. Marrëveshja është e plotfuqishme nëse miratohet nga Ministria.

Neni 14

Rendi i udhëtimit

1. Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:
 - 1.1. Emrin e operatorit;
 - 1.2. Relacionin;
 - 1.3. Llojin e transportit;
 - 1.4. Radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare;
 - 1.5. Kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje;
 - 1.6. Ditët e operimit, periudha kohore në të cilën mbahet linja;
 - 1.7. Afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendi i udhëtimit vlen tri (3) vite, me mundësi rishikimi për çdo vite
3. Drejtoria mban regjistrin e rendit të udhëtimit dhe bënë vazhdimin e rendit të udhëtimit
4. Operatori i transporti rrugor dhe të mallrave është i obliguar që transportin t'a kryej në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit të vërtetuar dhe të regjistruar.
5. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe vend-ndaljet të destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.
6. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vend-ndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

Neni 15

Fillimi i veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus

1. Operatori i transportit rrugor dhe të mallrave, duhet ta filloj veprimtarinë e transportit të rregullt publik të udhëtarëve në afat prej tri (3) ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, operatori i transportit rrugor dhe të mallrave mundet përkohësisht të ndërpres veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat e pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt.
3. Për ndërprerjen nga paragrafi 2. i këtij neni, operatori i transportit rrugor dhe të mallrave është i detyruar që të informoj organin i cili e ka vërtetuar rendin e udhëtimit, i cili organ do të lëshojë një vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.
4. Operatori i transportit rrugor dhe të mallrave nuk mundet ta ndërpret (pezulloj) veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në linjë sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar pa lejen e organit që e ka lëshuar atë rend të udhëtimit.
5. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet, transferohet dhe as të jepet me qira.
6. Transferimin e rendit të udhëtimit e benë vetëm Drejtoria.
7. Emri i operatorit i shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjti me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe certifikatën e autobusit sipas licencës "C", "D" ose licencës së Komunës.
8. Drejtoria për Shërbime Publike me vendim do të rregulloj ushtrimin e veprimtarisë së operatorëve të transportit rrugor gjatë festave zyrtare dhe vikendeve.
9. Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, në linjën e lejuar, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 16

Revokimi i rendit të udhëtimit

1. Rendi i udhëtimit do të revokohet nga Drejtoria në rastet kur:
 - 1.1. Në afat prej tri (3) ditësh nga dita e fuqizimit nuk ia fillon veprimtarisë pa ndonjë arsyetim sipas nenit 14 paragrafit 2 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2. Bënë ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të rendit të udhëtimit nuk mbanë nisjet pa miratimin e Drejtorisë.
 - 1.3. Kur operatori vepron në kundërshtim me aktet ligjore dhe këtë Rregullore;
2. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e rendit të udhëtimit e benë Inspektorati i Komunës.
3. Vendimi merret nga organi që e ka vërtetuar atë, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga inspektorët e transportit rrugor pranë Komunës.
4. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.
5. Drejtoria do të përcakton kushtet, kriteret, procedurat dhe tarifat për shpalljen e nisjeve të lira.

Neni 17
Çmimorja

1. Operatori i transportit bën kërkesë për caktimin e çmimit. Çmimoren e miraton Drejtoria përkatëse për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim. Çmimorja duhet të vendoset në mjetin transportues që qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime nga udhëtarët vetëm në bazë të çmimores nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 18
Biletat

1. Çdo udhëtar duhet të pajiset me biletë në relacion të caktuar përveç personave me aftësi të kufizuara të cilët posedojnë dokumente valide identifikimi.
2. Për transportin urban dhe urbano - periferik biletat mund të blihen në autobus, stacion të autobusëve, si dhe vende të tjera, tek të cilat operatori i transportit i ka besuar shitjen e tyre.
3. Bileta duhet të përmbajë:
 - 3.1.Relacionin;
 - 3.2.Çmimin;
 - 3.3.Numrin serik;
 - 3.4.Emrin e operatorit të transportit, dhe
 - 3.5.Datën dhe kohën e nisjes;

Neni 19
Kodi i veshjes

Personeli i automjetit transportues me të cilën kryhet transporti rrugor i udhëtarëve dhe personeli i stacioneve të autobusëve duhet të kenë rroba zyrtare (uniform).

Neni 20
Rregullat e mirësjelljes

Personeli i automjetit transportues me të cilën kryhet transporti rrugor i udhëtarëve gjatë orarit të punës duhet të respektojë rregullat e përgjithshme të mirësjelljes.

Neni 21
Dokumentet e nevojshme gjatë operimit në transportin rrugor të udhëtarëve

1. Gjatë transportit të rregullt urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve operatori është i detyruar që në autobus të ketë këto dokumente;
 - 1.1. Rendin e udhëtimit;
 - 1.2. Fletë urdhëresën e rrugës;
 - 1.3. Certifikatën e autobusit sipas licencës C, D apo licencës komunale.

Neni 22

Kushtet e mjeteve transportuese

1. Të gjitha automjetet me të cilët kryhet transporti publik urban i udhëtarëve duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull sipas dispozitave ligjore.

1.1. Automjetet me të cilat kryhet transporti publik urban duhet të kenë:

1.1.1. Në pjesën anësore të venë firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit;

1.1.2. Në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit;

1.1.3. Orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit të venë në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit

2. Automjeti duhet të plotësojë të gjitha kushtet higjieno-teknike të përcaktuara me ligj

3. Kur automjeti nuk bënë transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt".

4. Në sezonin e dimrit automjeti, para daljes në mbajtje të linjës, duhet të ngrohet.

Neni 23

Rregullsia e automjetit të transportit

1. Automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave në trafikun urban dhe urbano-periferik duhet të i plotësojnë kushtet teknike të rregullsisë së automjeteve.

2. Automjetet duhet të kenë urdhëresë-udhëtimit të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.

3. Çdo automjet i transportit rrugor të udhëtarëve në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, me barnatore manuale dhe me çekan për thyerjen e xhamit.

4. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve, shenjat e dyerve të hyrjes dhe të daljes.

5. Automjeti i transportit rrugor të udhëtarëve duhet të jetë me dysheme të ulët i përshtatshëm për persona me aftësi të kufizuara (dyert duhet të jenë të pajisura me zile për persona të verbër).

6. Automjeti i transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave i ndalohej vendosja e fotografive dhe materialeve tjera që kanë karakter ofendues apo pornografik.

Neni 24

Nisja dhe ndalja e automjeteve të transportit të udhëtarëve

1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit të transportit të udhëtarëve e jep personeli i automjetit.

2. Vetëm personeli i automjetit hapë dhe mbyllë dyert e automjetit.

3. Personeli i automjetit nuk guxon të japë shenjë për nisje deri sa të konstatojë se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

4. Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektojë itinerarin e linjës, të cilin duhet të ketë në automjet dhe ndalet patjetër në të gjitha stacionet, përkatësisht vend-ndaljet e linjave të tyre.

5. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit të transportit ka për detyrë të njoftojë udhëtarët për këtë.

6. Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve nuk mund të ndalë-parkojë automjetin më gjatë se 10 minuta në stacionin e nisjes.

7. Drejtuesi i automjetit nuk mund të nisë automjetin para se të ketë vërtetuar se janë mbyllur dyert e hyrjes dhe të daljes.

8. Derisa automjeti është në lëvizje, dyert duhet të jenë patjetër të mbyllura.

Neni 25

Ndërprerja e udhëtimit

1. Në rast të ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve të ua sigurojë daljen e sigurt nga automjeti i transportit të udhëtarëve.
2. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi detyrohet që udhëtarëve të ua mundësojë që me të njëjtat bileta të vazhdojnë udhëtimin me automjet tjetër.

Neni 26

Obligimet e udhëtarit

1. Udhëtarët hyjnë në automjetet e transportit të udhëtarëve në dyert e shënuara për hyrje dhe zbesin në dyert e shënuara për dalje.
2. Personat me aftësi të kufizuara fizike, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta mund të hyjnë në dyert e daljes.
3. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtarit duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.
4. Udhëtarit është i obliguar që me kërkesën e personit të autorizuar, të tregoj biletën përkatëse të udhëtimit.

Neni 27

Gjërat tjera që mund të transportohen

1. Udhëtarit mund të futë në automjet bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjahut ose të sportit me këllëf, skitë dhe kompletin për peshkim.
2. Në automjet mund të futën, qenët me shportë në turi, zyrtarë dhe qenët ciceron të personave të verbër.

Neni 28

Masat ndaj udhëtarit

1. Udhëtarit i cili gjendet pa biletë udhëtimi në automjet e transportit të udhëtarëve është i obliguar që me kërkesë të personit të autorizuar të bëjë kompensimin në të holla të biletës dhe gjobën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës.
2. Nëse udhëtarit refuzon të bëjë pagesën nga paragrafi 1 i këtij neni, detyrohet që personit të autorizuar t'i japë të dhënat e sakta për identitetin e vet.
3. Udhëtarit, i cili dëmton apo e ndotë automjetin, është i detyruar të kompensojë dëmin, përkatësisht të paguaj pastrimin e tij.
4. Nëse udhëtarit refuzon të bëjë kompensimin, përkatësisht pagesën nga paragrafi 3 i këtij neni, është i detyruar që personelit të automjetit t'i japë të dhënat e sakta për identitetin e vet.

Neni 29

Sendet e gjetura

1. Sendet e gjetura në automjetin e transportit të udhëtarëve i dorëzohen personelit të automjetit i cili për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura. Nëse pronari i sendeve të gjetura nuk gjendet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato i dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të operatorit të transportuesit.
2. Operatori i transportuesit detyrohet që sendet e gjetura, në afat prej 7 ditësh, t'i dorëzojë policisë.

Neni 30

Transporti i veçantë

1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara udhëtarësh duke përjashtuar udhëtarët tjerë në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.
2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti:
 - 2.1. Nxënësve dhe studentëve nga vendbanimi deri në destinacion e caktuar dhe anasjelltas.
 - 2.2. Punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas.
 - 2.3. Invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë.
3. Lejet për transport të veçantë lëshohen në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:
 - 3.1. Relacionin;
 - 3.2. Listën e udhëtarëve;
 - 3.3. Çmimin e transportit;
 - 3.4. Vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve, dhe
 - 3.5. Kohën gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Kontratën e bënë transportuesi, paraprakisht i licencuar nga Ministria ose Komuna dhe porositësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve ku porositësi është njëkohësisht edhe pages i transportit
5. Lejen për transport sipas këtij neni e lëshon Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
6. Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të veçantë jepen kundrejt pagesës që parasheh Rregullorja e Komunës për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
7. Lejet sipas këtij neni nuk përmbajnë rendin e udhëtimit dhe çmimoren e përcaktuar sipas kësaj Rregulloreje.
8. Në autobus në pjesën e përparme në vend të dukshëm duhet të jetë mbishkrimi "Transport i veçantë".
9. Operatori i transportit është i detyruar që të gjithë udhëtarët t'i pajisë me kartelë identifikimi.

Neni 31

Transporti për nevoja vetanake

1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik dhe qytetari i cili ka automjetin transportues, mund të kryej transport për nevoja vetanake dhe atë transportin e punëtorëve të vetë ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vetë, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.
2. Transport i udhëtarëve për nevoja vetanake, në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohet edhe transporti i personave të cilët bëjnë:
 - 2.1. Ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridik dhe fizik të cilët kryejnë veprimtari hoteliere;
 - 2.2. Institucionet shëndetësore si dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit;
 - 2.3. Agjencitë turistike, personat tjerë juridik e fizik të cilët kryejnë veprimtari turistike ku, në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës;
 - 2.4. Shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vetë;
 - 2.5. Auto-shkollat të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre;
 - 2.6. Operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta;

3. Transporti për nevoja vetanake të udhëtarëve janë operacione që kryhen për qëllime jo-komerciale dhe jo-fitimprurëse nga një person fizik ose juridik, për te cilat:

3.1. Aktiviteti i transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për atë person fizik ose juridik, si dhe

3.2. Mjetet e përdorura janë pronë e atij personi fizik ose juridik, ose kanë qenë objekt i një kontrate mbi qiranë dhe drejtohen nga një anëtar i stafit të personit fizik apo juridik ose personi fizik apo vetë nga personeli i punësuar nga ai, ose të vënë në dispozicion të ndërmarrjes nën një detyrim të kontraktuar.

Neni 32

Dispozitat e transportit për nevoja vetanake

1. Veprimtaria e transportit për nevoja vetanake i nënshtrohet marrjes së një autorizimi / certifikate, të lëshuar nga Drejtoria.

2. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja vetanake duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë i vërtetuar nga ana e pronarit (operatorit), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit të këtyre punëtorëve ose personave.

3. Në të dy anët, ose në këndin e djathtë të poshtëm të xhamit mbrojtës të autobusit, me të cilët kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja vetanake, duhet të jetë i shënuar mbishkrimi “Transporti për nevoja vetanake”.

Neni 33

Transporti në kushte të jashtëzakonshme

Komuna në kushtet e jashtëzakonshme nxjerr urdhëresë për transportin e detyruar të udhëtarëve në relacione të caktuara dhe periudhë të caktuar.

Neni 34

Stacionet e autobusëve

Stacioni i autobusëve është objekti me infrastrukturën e saj përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtar, gardërobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët e transportit rrugor.

Neni 35

Kategorizimi i stacioneve të autobusëve

1. Stacioni i autobusëve nën kushte të barabarta iu ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues që kanë rendin e udhëtimit, lejen për transport të regjistruar dhe vërtetuar në Ministrinë përkatëse për transport apo Komunë sipas tarifës të përcaktuar nga Ministria përkatëse e bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.

2. Personat zyrtar të stacionit të autobusëve janë të detyruar që në vend të dukshëm të mbajnë kartelën identifikuese.

Neni 36

Detyrimet e stacioneve të autobusëve

1. Stacioni i autobusëve nuk ofron shërbime për operatorët e transportit të cilët nuk kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga Komuna nëse është fjala për transport urban dhe urbano-periferik.
2. Stacioni i autobusëve duhet të ketë mbishkrimin “Stacioni i autobusëve” si dhe emërtimin e vendit ku gjendet stacioni.
3. Personeli i stacioni të autobusëve është i detyruar që të mbajë librin e evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve dhe për të njëjtën gjë të raportoj në Ministri dhe Komunë në periudha tre (3) mujore.
4. Libri i evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve duhet të ketë këto të dhëna:
 - 4.1. Emrin e operatorit të transportit;
 - 4.2. Emrin e linjës sipas rendit të udhëtimit;
 - 4.3. Koha e nisjes dhe e ardhjes së autobusit;
 - 4.4. Targat e regjistrimit të automjetit;
 - 4.5. Flet urdhëresën e rrugës (Nr. Serik).
5. Me hyrjen në fuqi të rendit të udhëtimit, stacioni i autobusëve është i detyruar të bëjë sistematizimin e të gjitha rendeve të udhëtimit sipas relacioneve, kohën e nisjes së autobusit nga stacioni i tij.
6. Licencën për stacionet për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të transportit urban dhe urbano-periferik e lëshon Komuna.

Neni 37

Detyrimet tjera për stacionin e autobusëve

1. Stacionet dhe vend-ndaljet e autobusëve në linjat e përhershme i cakton me plan Drejtoria.
2. Stacionet dhe vend-ndaljet në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
3. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës në pjesë të ndarë të rrugës.
4. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose e betonuar.
5. Stacioni apo vend-ndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta duhet të kenë nën pullazet.

Neni 38

Mirëmbajtja

1. Për rregullimin e stacioneve dhe vend-ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave kujdeset Drejtoria.
2. Drejtoria mund të bënë shpërndarjen ose transferimin e stacionit dhe të vend-ndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe sigurisë në trafik.

KREU III

KUSHTET PËR SHËRBIMIN E TRANSPORTIT PËR “MERIMANGË”

Neni 39

1. Shërbimi i transportit për “merimangë” duhet të jetë i licencuar.
2. Kushtet për licencim janë:
 - 2.1. Të jetë regjistruar për ushtrimin e shërbimit për merimangë
 - 2.2. Të ketë së paku tre (3) automjete për bartje të automjeteve.
 - 2.3. Të ketë së paku njëzetë (20) bllokues rrotash me ngjyrë të verdhë.
 - 2.4. Të ketë sistem funksional të komunikimit
 - 2.5. Të sigurojë shërbimin 24/7 në javë
 - 2.6. Të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë
 - 2.7. Të ketë vend parkimin për vendosjen e automjeteve (të dëshmuar me listë poseduese ose kontratë mbi shfrytëzimin).
 - 2.8. Të ketë zyre administrative (me seli në Komunën e Podujevës).

Neni 40

1. Kushtet për automjetet bartëse:
 - 1.1. Të jenë të regjistruara në Komunën e Podujevës.
 - 1.2. Të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve
 - 1.3. Të jenë teknikisht në rregull në çdo kohë
 - 1.4. Të kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie
 - 1.5. Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet
 - 1.6. Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Neni 41

1. Kushtet për drejtuesit e automjeteve:
 - 1.1. Të jenë punëtorë të regjistruar te operatori
 - 1.2. Të kenë patentë shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjësisht
 - 1.3. Të ketë ndihmësin për kryerjen e bartjes

Neni 42

Pagesa për lirim (rimarrjen e automjetit)

1. Operatori si kusht për lirim e automjetit, pronarin, drejtuesin e automjetit do t'ja ngarkojë me pagesë si më poshtë:
 - 1.1. Për tërheqjen e auto veturave brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës së përcaktuar me akte ligjore në fuqi.
 - 1.2. Për tërheqjen e kombi-busëve dhe xhipave brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës me akte ligjore në fuqi.
 - 1.3. Për tërheqjen e kamionëve dhe autobusëve brenda qytetit do të paguhet sipas tarifës me akte ligjore në fuqi.
 - 1.4. Për tërheqjen e automjeteve nga zonat jashtë qytetit përveç çmimeve të caktuara duhet të paguhet operatori në bazë të akte ligjore në fuqi.

- 1.5. Në rast se pronari përkatësisht drejtuesi i automjetit largon automjetin para se të arrijë automjeti për bartje paguan gjysmën e tarifës të caktuar.
- 1.6. Nëse automjeti nuk tërhiqet brenda 48 orëve pas kësaj kohe për çdo 24 orë do të paguhet sipas tarifës së caktuar nga Komuna.
2. Të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do të bëhen përmes bankës së caktuar, si të hyrat e Drejtorisë.
3. Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria e Financave.
4. Për secilën pagesë do të lëshohet fatura e cila do të jetë rendore dhe do të përmbajë këto të dhëna:
- markën dhe modelin e automjeteve
 - numrin e targave
 - emrin e plotë, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të pronarit
 - emrin e plotë dhe numrin e letërnjoftimit të personit të cilit i lirohet automjeti
 - datën e bllokimit të automjetit
 - datën e lirimit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar)

Neni 43

1. Drejtoria here pas here do t'i kontrollojë të dhënat e operatorit lidhur me shërbimet e bëra, pajisjet dhe vendin për parkim. Drejtoria ka të drejtën e kontrollimit të të dhënave edhe pas skadimit apo të ndërprerjes së kontratës dhe atë në periudhën prej pesë viteve.
2. Sipas kërkesës së drejtorisë operatori obligohet që të sjellë faturat e ruajtura për arkivim në Drejtori.
3. Operatori i dorëzon llogarinë mujore të punuar sipas Rregullores për Taksa dhe Tarifa të Komunës.
4. Operatori në përputhshmëri me Rregulloren për Taksa dhe Tarifa do të bëjë pagesat mujore në xhirollogarinë e caktuar nga Komuna.

Neni 44

Në rast të shkeljes së ndonjërës nga dispozitat e kësaj rregulloreje, Drejtoria mban të drejtën e shkëputjes së kontratës për çka edhe do të njoftohet operatori me kohë

KREU IV TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 45

Transporti rrugor i mallrave vendor kryhet si transport i mallrave për nevoja vetanake (për llogari të vet) dhe transport i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë).

Neni 46

Transporti i mallrave për nevoja vetanake

1. Transporti i mallrave për nevoja vetanake konsiderohet transporti të cilin e kryen personi fizik apo juridik pa kompensim, nëse plotësohen kushtet si në vijim:
- 1.1. Malli i cili transportohet duhet të jetë në pronë të personit juridik apo fizik ose i shitur, i blerë, i dhënë apo i marrë me qira, i prodhuar, plotësuar ose riparuar nga personi juridik apo fizik i cili e kryen këtë transport për nevoja vetanake;
- 1.2. Qëllimi i transportit duhet të jetë nga ose deri tek personi juridik apo fizik i cili e kryen transportin për nevoja vetanake, për të transferuar mallin brenda ose jashtë selisë së personit juridik apo

- vendqëndrimin e personit fizik i cili e kryen transportin për nevoja vetanake;
- 1.3.Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasin shoferët të punësuar tek personi juridik apo fizik ose vet personi fizik;
- 1.4.Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit;

Neni 47

Transporti i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë)

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë) kryhet në bazë të marrëveshjes më shkrim ose me gojë në mes të dërguesit dhe marrësit të mallit i cili kontraktin transportin e mallrave.
2. Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasë vet personi fizik ose shoferët e punësuar tek personi juridik apo fizik.
3. Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit.

Neni 48

Dokumentet e nevojshme gjatë transportit rrugor të mallrave

1. Gjatë transportit të mallrave operatori në automjet duhet të posedoj këto dokumente:
 - 1.1.Për transport vendor:
 - 1.1.1.Certifikata e automjetit (ekstrakt nga Licenca);
 - 1.1.2.Flet urdhëresën e rrugës.

Neni 49

Përfshirjet nga regjimi i lejeve

1. Leje për transportin e mallrave nuk nevojitet:
 - 1.1.Për automjetet me peshë vetanake deri tre pikë pesë (3.5) tonelata dhe peshën më të madhe të lejuar gjashtë (6) tonelata përfshirë edhe ngarkesën;
 - 1.2.Për transportin e automjeteve dhe rimorkiove të dëmtuara;
 - 1.3.Për transportin e dërgesave postare;
 - 1.4.Për transportin e ekspozitave të destinuara për panairë dhe ekspozita;
 - 1.5.Për transportin të materialit mjekësor apo materialit tjetër, si ndihma në rast fatkeqësish natyrore;
 - 1.6.Për hyrje të automjeteve të zbrazët për ndërrim automjeti defekt dhe marrje të sendeve përsipër për transportim nga automjeti defekt;
 - 1.7.Për automjete të ndihmës teknike për tërheqje të automjeteve defekte (automjeteve serviso-riparuese);
 - 1.8.Për transportin e kufomave;
 - 1.9.Për transportin në rast të shpërnguljes;
 - 1.10.Për transportin e pajisjeve ndihmëse dhe nevojave tjera për teatër, koncerte dhe paraqitjeve tjera kulturore, si cirku, si incizimet e filmave si dhe incizimet në radio apo televizion;
 - 1.11.Për transportin e zogjve dhe peshqve (te ri) për kultivim;
 - 1.12.Për transportin e mallrave për çështje marketingu apo për ligjërata universitare.

Neni 50

Ndalimi i transportit të mallrave

Komuna do të nxjerr urdhëresa për ndalimin e transportit të mallrave nëpër rrugë të caktuara lokale, lloje të caktuara dhe periudhë të caktuara. Komuna njofton opinion lidhur më nxjerrjen e një urdhërese të tillë.

KREU V

REGJIMI I NGASJEJS DHE PUSHIMIT

Neni 51

Ngasja në ekip

1. Mosha minimale e ngasësve që ofrojnë transport të mallrave është e përcaktuar si në vijim:
 - 1.1.Për mjetet që përbëhen nga rimorkio apo gjysmë-rimorkio, pesha maksimale e autorizuar e të cilëve është më e vogël apo baras me shtatë pikë pesë (7.5) ton, mbi tetëmbëdhjetë (18) vjeç;
 - 1.2.Për mjetet tjera, mbi njëzetënjë (21) vjeç;
2. Ngasësit që kryejnë transportim të udhëtarëve duhet të jenë së paku njëzetënjë (21) vjeç. Ngasësit që kryejnë transport të udhëtarëve përmes linjave që tejkalojnë pesëdhjetë (50) km përreth pikave të zakonshme të ndalimit të mjetit duhet të përmbushin njërin nga kushtet në vijim:
3. Të kenë ushtruar për së paku një (1) vit aktivitetin e ngasësit që kryen transport mallrash për mjetet pesha maksimale e lejuar e të cilëve tejkalon tre pikë pesë (3.5) ton;
4. Të kenë ushtruar për së paku një (1) vit aktivitetin e ngasësit për transportim udhëtarësh në rrugëtime që nuk tejkalojnë pesëdhjetë (50) km përreth pikës së zakonshme të ndalimit të mjetit, apo llojeve tjera të shërbimeve të transportimit të udhëtarëve.

Neni 52

Koha e ngasjes

1. Kohëzgjatja e ngasjes ditore, e përkufizuar në këtë Rregullore, nuk tejkalon nëntë (9) orë. Ajo mund të zgjatet në maksimalisht dhjetë (10) orë, por jo më shumë se dy (2) herë gjatë javës.
2. Kohëzgjatja e ngasjes javore, e përkufizuar në këtë Rregullore, nuk tejkalon pesëdhjetëgjatë (56) orë:
 - 2.1.Kohëzgjatja e ngasjes totale të akumuluar gjatë dy (2) javëve të njëpasnjëshme nuk tejkalon nëntëdhjetë (90) orë;
 - 2.2.Koha e ngasjes përbëhet nga e tërë kohëzgjatja e ngasjes e kryer në çfarëdo territori;
 - 2.3.Ngasësi e regjistron në formë të punës tjetër tërë kohën gjatë kryerjes të detyrave tjera, si dhe kohën e kaluar gjatë ngasjes së mjetit të përdorur për operacione komerciale që nuk bie në fushëveprim të kësaj Rregulloreje, si dhe regjistron periudhat e disponueshmërisë. Ky regjistrim futet manualisht në fletë të të dhënave apo fletë të shtypur apo me anë të futjes manuale të mjetit të inspektimit.

Neni 53

Ndërprerjet dhe pushimet

1. Pas ngasjes prej katër orë e gjysmë ngasësi merr një pauzë të pandërprerë prej së paku dyzetepesë (45) minutash.
2. Kjo ndërprerje mund të zëvendësohet me anë të një ndërprerjeje prej pesëmbëdhjetë (15) minutash vijuar nga një ndërprerje prej së paku tridhjetë (30) minutash, ku që të dyja shpërndahen në kohën e ngasjes apo merren menjëherë pas saj, në atë formë që respektohet dispozita e paragrafit 1. të këtij neni.
3. Ngasësi i transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave ka të drejtë në pushim javor jo më pakë se një (1) ditë në javë.

Neni 54
Shmangiet

1. Me kusht që nuk e cenon sigurinë rrugore dhe që i lejohet arritja e një ndalimi të përshtatshëm, ngasësi mund të shmanget dispozitave të kësaj Rregulloreje nëse është e nevojshme për të ofruar siguri të personave, mjetit apo ngarkesës së tij.
2. Ngasësi duhet të cekë natyrën dhe qëllimin e shmangies në një fletë të të dhënave apo në fletë të shtypur të aparatit të kontrollit apo në regjistër të shërbimit, më së voni në kohën e arritjes në vendndalimin e përshtatshëm apo para saj.

KREU VI
MBIKQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 55

Mbikëqyrja dhe kontrolli në transportin rrugor

Mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi zbatimin e këtij e kësaj Rregulloreje e bën Komuna përkatësisht inspektorët e transportit rrugor dhe Policia e Kosovës brenda kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 56

Inspektimi në transportin rrugor

1. Punët e inspektimit në transportin rrugor urban, urban periferik, mallrave dhe transportin auto taksi brenda territorit të komunës i bënë inspektori i transportit rrugor komunal dhe Policia e Kosovës (policia e trafikut) në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj.
2. Detyrimet e operatorit Operatori i transportit rrugor është i detyruar t'i paraqesë inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijojë atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave dispozitave të ligjit për transportin rrugor.

KREU VII
DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 57

1. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik për kundërvajtje do të dënohet në gjobë prej njëzet e pesë (25 deri njëqind (100) euro, për rastet kur:
 - 1.1.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 paragrafët 1, 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.2.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.3.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.4.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 13 paragrafit 4, 5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.5.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 paragrafët 1, 3,4 dhe 9 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.6.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.7.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 17 paragrafi 1të kësaj Rregulloreje;
 - 1.8.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 18 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.9.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 19 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.10.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 20 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.11.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 21 të kësaj Rregulloreje;

- 1.12.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 22 të kësaj Rregulloreje;
- 1.13.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 23 paragrafët 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje;
- 1.14.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 24 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje;
- 1.15.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 paragrafët 3 dhe 4 të kësaj Rregulloreje;
- 1.16.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 të kësaj Rregulloreje;
- 1.17.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 paragrafët 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje;
- 1.18.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 29 paragrafët 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje;
- 1.19.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 32 të kësaj Rregulloreje;
- 1.20.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të kësaj Rregulloreje;
- 1.21.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 36 paragrafi 2 të kësaj Rregulloreje;
- 1.22.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje;
- 1.23.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 41 të kësaj Rregulloreje;
- 1.24.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 të kësaj Rregulloreje;
- 1.25.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 43 të kësaj Rregulloreje;
- 1.26.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 44 të kësaj Rregulloreje;
- 1.27.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 të kësaj Rregulloreje;
- 1.28.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 46 të kësaj Rregulloreje;
- 1.29.Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 të kësaj Rregulloreje;
2. Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni personi juridik për kundërvajtje do të dënohet me gjobë prej shtatëdhjetë (70) deri në shtatëqind (700) euro
3. Po qese operatori i transportit përkatësisht personi tjetër juridik apo fizik bën përsëritje të kundërvajtjes së njëjtë, përveç dënimit me gjobë do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 58

Refuzimi dhe dhënia e informatave

1. Nëse një operator refuzon të kthej dokumentet e transportit pas një dënimi të tërheqjes së përkohshme apo të përhershme të certifikatave të automjeteve apo licencës ose autorizimit për transportin dënohet me gjobë prej tetëdhjetë (80) deri në tetëqind (800).
2. Nëse një operator me vetëdije jep informata të pavërteta për të marrë një licencë ose certifikatë të mjeteve të transportit ose licencën e kërkuar për kryerjen e veprimtarisë së transportit me gjobë prej tetëdhjetë (80) deri në tetëqind (800).

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË PËRFUNDIMTARE

Neni 59

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Për të gjitha çështjet tjera që nuk janë të parapara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi transportin rrugor dhe udhëzimet përkatëse të ligjit.

Neni 60

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen organet kompetente Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Inspeksionit dhe Policia e Kosovës.

Neni 61

Pjesë e kësaj Rregulloreje janë:

- SHTOJCA I: Forma e Licencës së transportit;**
- SHTOJCA II: Certifikata e mjetit transportues;**
- SHTOJCA III: Forma e Lejes së transportit;**

Neni 62


Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për organizimin e transportit në Komunën e Podujevës nr.01/82-110, më 29 prill 2011.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-345/01-0008883/23
Podujevë, datë, 31 janar 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha